

Annex 1 to
Submission of Publicly Redacted Statement of Nasim Haradinaj
(ALB)
Publicly Redacted

DEKLARATA E NASIM HARADINAJT SI DËSHMITAR***Historiku***

1. Unë Nasim HARADINAJ, i biri i Ismajlit, kam lindur më 21 maj 1963 në Glllogjan, komuna e Deçanit, Kosovë. Banoj në Glllogjan, komuna e Deçanit, Kosovë. Jam shtetas i Republikës së Kosovës (numri personal 2021293167).
2. Shkollën fillore e kam kryer në fshatin Gramoqel, Komuna e Deçanit dhe të mesmen në Deçan. Veprimtarinë time kombëtare e kam filluar qysh në moshë të re, fillimisht u frymëzoja nga gjyshërit e mi të cilët tregonin ngjarje se si xhandarmëria serbe e Milic Kerstes i vriste shqiptaret dhe dhunshëm i dërgonin shqiptaret në Manastir te Deçanit për t'i konvertuar me dhunë në fenë pravosllave dhe po ashtu për t'ua ndryshuar edhe identitetin kombëtar. Popi i Manastirit i konvertonte me dhunë duke i stërpikur me ujë, përderisa nëpër fshatra serbët i kishin okupuar shtëpitë e shqiptarëve duke i detyruar të flinin në shtalla, ku sistematikisht i maltretonin dhe vritnin shqiptarët. Kjo përndjekje ndaj shqiptarëve dhe familjes sonë u vazhdua edhe në kohën e Rankoviqit e më tutje gjatë sistemit të Jugosllavisë socialiste.
3. Aktivitetin tim për çlirimin e trojeve tona e kam filluar qysh në shkollë të mesme. Nga moshë 15-vjeçare jam angazhuar në aktivitete politike kundër shtypjes jugosllave dhe me vone me shokë kam krijuar grupin politik, të quajtur "Shqiponja", ku edhe isha si kryetar grupi. Pas shumë aktiviteteve të organizuara nga Shqiponja (p.sh., shlyerja e emrave serbë të rrugëve) dhe organizimi i demonstratave në vitin 1981, u arrestova mesnatën e 1 prillit të atij viti për organizimin e atyre aktiviteteve nga Sigurimi Shtetëror i Jugosllavisë së bashku me babain Ismajl HARADINAJ dhe motrën Shqipen 15 vjeçare. Më akuzuan për propagandë dhe veprimtari armiqësore kundër shtetit. Babai ishte angazhuar shumë me herët së bashku me Jusuf Gërvallën të cilin më 1982 e vranë shërbimi i sigurimit sekret Jugosllav së bashku me vëllanë Bardhoshin dhe shokun e tyre Kadri Zekën në Untergruppenbach të Gjermanisë. Ismaili organizonte dhe formonte grupet politike që vepronin në tërë Kosovën për çlirimin e shqiptarëve që ishin brenda territorit të Jugosllavisë së atëhershme dhe ishte udhëheqës i grupit të Komitetit për Deçanin. Babain dhe mua na burgosen. Atë e dënuan me

dënim unik 16 vite dhe mua, me dënuan me 5 vite burg, që ishte dënim shumë i rëndë për një të mitur. Më dërguan në Serbi që ta vuaja dënimin jashtë Kosovës por në burgjet që ishin për te rritur dhe në ato ndër me te rëndat dhe famëkeqet si Nishi dhe Leskovci.

4. Pas lirimimit më privuan nga e drejta e shkollimit dhe pas tetë vitesh mezi u regjistrova me korrespondencë në Fakultetin e Kimisë në Universitetin e Prishtinës. Gjatë gjithë kësaj kohe periodikisht jam bastisur dhe jam thirr ne biseda informative dhe me kane torturuar nga pjesëtarët e shërbimit informativ serb. Kjo ndodhte sepse babai im ishte vazhdimisht në burg dhe vëllai im ishte në arrati. Inteligjenca serbe shpesh më rrihte për të më shtyrë t'u tregoja se ku ishte vëllai im, Naimi – pasi ai kishte ikur në Suedi në atë kohë. Inteligjenca serbe vazhdonte të më bënte presion për të bashkëpunuar me ta, por nuk do ta bëja kurrë. Kjo më ndodhte përafërsisht katër herë në vit.
5. Në vitin 1985 jam fejuar me Gjejlone GJIKOKAJN ku për këtë arsye atë e larguan nga fakulteti i Fizikes edhe pse ishte absolvente duke e cilësuar si armike te ati sistemi, edhe me tej na u shtua përndjekja dhe vendosem te ikim në Shqipëri. Në Tropojë të Shqipërisë qëndruam tri javë, pastaj u kthyem në Kosovë. Pas kthimit në Kosovë, unë dhe e fejuara ime u dënuam me burg për kalim ilegal kufiri. Mua më mbanin në Pejë e fejuara ime vuante dënimin në Mitrovicë. Pas lirimimit nga burgju, u martuam po atë ditë, pa asnjë ceremoni.
6. Pas shumë bastisjeve të policisë, një ditë në vitin 1989, rreth orës 4 të mëngjesit shtëpia jonë u rrethua nga policia; dhe pas një bastisjeje të gjatë më arrestuan, pa thënë asgjë se ku do të më dërgonin dhe sa do të më mbanin. Atë ditë u arrestuan njëqind e shtatë (107) intelektualë anembanë Kosovës dhe na dërguan ne izolim jashtë Kosovës, pra ne Serbi. Mua me disa te tjerë me dërguan se pari ne Leskovc ku na kanë torturuar dhe rrahur brutalisht dhe pastaj nga lëndimet qe i morëm aty u detyruan te me dërgonin ne spitalin e burgut “CZ” ne Beograd. Për tridhjetë (30) ditë s’ka ditur askush për ne dhe gjatë asaj kohe jemi kërcënuar vazhdimisht se do të na vrisnin ata që na kishin paraburgosur. Pas ndërhyrjes së Kryqit të Kuq ndërkombëtar na liruan ku edhe pas atyre ditëve shiheshin lëndimet dhe plagët e rrahjeve.

7. Unë kam qenë i përfshirë edhe në grupin iniciatorë për zhdukjen e hakmarrjeve në vitin 1990, ku ishin pajtuar qindra familje shqiptare. Shqiptarët dikur vriteshin me njëri tjetrin për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet – por këto vrasje nuk u trajtuan siç duhet në gjykatat serbe. Kështu që u ndërtua një sistem gjakmarrjeje për t'u marrë me vënien e drejtësisë në vend për ata që vriteshin. U detyrova që nga ajo kohe të jetoja ilegalisht neper Kosove sepse me kërkonin sigurimi dhe se tashme kisha vendosur të mos ju dorëzohem me.
8. Pas një serie të bastisjeve në shtëpi duke dashur të më arrestonin, ku në shtëpi gjenin vetëm gjyshen dhe gruan, vendosa të largohem nga Kosova në prill të vitit 1990 dhe arrita në mënyrë klandestine në Suedi për të qëndruar më vëllanë Naimin. Pas tre muajsh, në korrik 1990, arritën po ashtu edhe gruaja me tre fëmijët në Suedi, po ashtu në mënyrë klandestine.
9. Në Suedi kam punuar si përkthyes zyrtar deri në vitin 1997. Gjatë kësaj kohe u angazhova intensivisht në aktivitete organizuese dhe përkrahëse të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Kam qenë pjesëtar aktiv dhe i organizuar i kësaj ushtrie vullnetare çlirimtare.
10. Kam organizuar shumë takime në shumë vende të botës dhe kam sensibilizuar opinionin për luftën e domosdoshme çlirimtare dhe të drejtë ku nga këto organizime kanë nxjerr mija vullnetare dhe financa për përpjekjet e luftës.
11. Në Kosovë kam hyrë për herë të parë i armatosur në janar të vitit 1998. Megjithatë, në prill të vitit 1998 jam kthyer përfundimisht në Kosovë për të luftuar në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Në Kosovë kam qenë në vijën e parë të frontit në disa fshatra të zonës së Deçanit . Ne fund të muajit maj 1998 jam plagosur në koke dhe në fillim të Qershorit kthehem në Shqipëri ku punoj për unifikimin e forcave që gjendeshin neper Shqipëri dhe krijuam se bashku me të tjerët një force që theu kufirin dhe morëm në duart tona zyrtarisht kazermën e parë dhe të vetmen gjatë gjithë kohës së luftës në Kosovë. Pra, kjo brigadë ishte e veçantë dhe në koordinim të rregullt me oficerë shqiptarë dhe amerikanë. Ne arritëm atë që sot njihet si Beteja e Koshares dhe Serbia është e vetëdijshme për efektin e saj. Gjatë betejës së Koshares (9 prill-10 qershor 1999), forcat e UÇK-së u mbështetën nga NATO, dhe kjo ishte një nga betejat më të përgjakshme gjatë luftës.

12. Kurrë nuk synoja të bëhesha komandant apo të marr ndonjë pozitë të caktuar ushtarake, por qëllimi im ishte thjesht çlirimi i Atdheut, dhe nuk kam kursyer asgjë as unë e as familja ime e gjere për të arritur lirinë e vendit tim.
13. Pas çlirimit kam punuar një kohë të shkurtër në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) nga viti 1999 deri ne vitin 2001. Pas kësaj u ktheva prape ne Skandinavi dhe punova një vit e gjysme ne Norvegji dhe u ktheva serish ne Kosove. Në këtë periudhë kryesisht punoja tokën dhe merresha me bujqësi.
14. Hysni GUCATI-n e kam takuar për herë të parë rreth Marsit 2004 ose 2005 në një ngjarje përkujtimore të luftës, kur isha në vizitë në Skenderaj.
15. Më 2010 u emërova drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë në Komunën e Deçanit ku kam ushtruar këtë detyre deri ne vitin 2019.
16. Më 15 shtator 2017, Hysni Gucati u zgjodh Kryetar i OVL-së së UÇK-së. Pas zgjedhjes së tij, unë u zgjodha si nënkryetar dhe zëdhënës i OVL-së së UÇK-së në Prishtinë dhe shërbeva në këtë detyrë derisa u burgosa nga DHS dhe ZPS në Hagë më 25 shtator 2020.

DHS dhe ZPS

17. Është e rëndësishme të theksohet që nga fillimi i vitit 2019 deri para zbulimit të parë, i njohur si “Rrufeja 1”, OVL e UÇK-së u përball me shumë kritika nga të gjitha anët - qeveria, opozita, nga disa media dhe anëtarë të shoqërisë civile (që merrnin fonde ndërkombëtare). Ky presion ndaj OVL-së së UÇK-së u rrit kur mblodhëm 11700 nënshkrime me të cilat kërkohej që Kuvendi i Kosovës të ndryshonte ligjin për DHS. Ne po kërkonim futjen e një amendamenti që parashikonte hetime për të **gjitha krimet** e kryera, pavarësisht se kush i ka kryer ato. Për të qenë të qartë, ne nuk po kërkonim shfuqizimin apo mbylljen e DHS, pasi që besonim në drejtësi, vetëm donim të siguroheshim që të gjithë personat, përfshirë kriminelët serbë të luftës, të mbaheshin llogaridhënës. Dështimet e DHS i konsideruam aq të rëndësishme dhe në kundërshtim me çdo parim të drejtësisë, saqë duhej të adresoheshin nga ligjvënësit tanë. Kjo seancë dështoi pas ndërhyrjeve nga jashtë, por ne u përpoqëm sërish të kërkojmë një seancë tjetër nga Kuvendi, për të diskutuar të njëjtat çështje dhe për të mos zgjatur

mandatin e DHS që skadonte në gusht 2020 për shkak të mosrespektimit të standardeve të drejtësisë. Ne u dërguam kërkesa Presidentit të atëhershëm të Kosovës (Hashim Thaçi), Kryetares së Kuvendit (zonjës Vjosa Osmani), si dhe të gjithë kryetarëve të grupeve parlamentare përfshi këtu edhe Listën Serbe si përfaqësuese e serbeve në kuvend.

18. Qëllimi kryesor i OVL-së ishte të ndryshohej ligji përkatës që të sigurohej që DHS duhej të ndiqnin të gjithë kriminelët që kryen krimet – kushdo qofshin ata - serbë dhe shqiptarë të Kosovës. Qëndrimi i OVL-së ishte se nëse Qeveria e Kosovës refuzonte ta pranojë këtë, OVL do vazhdonte mos mbështetjen e ZPS-se dhe mandatin e DHS. Sepse kështu siç ishin duke u sjelle (DHS/ZPS) dukej qartë se janë selektive dhe monoetnike, sepse ndryshe ne nuk do kishim asgjë kundër. Pra, ne mbështesim drejtësinë por jo drejtësi selektive dhe të ndërtuar vetëm mbi të dhënat e organeve çetnike serbe, e konkretisht nga vet ekzekutorët e krimeve.
19. Pas kësaj, OVL priste që se paku kur të kthehej qeveria nga pushimet verore të organizonin një seance në parlament për këtë temë, por nuk e bënë. Kjo seance nuk u mbajt kurrë edhe pse ne u kishim siguruar nënshkrimet e 7 deputeteve që ishin mjaftueshme për ta bërë obligative thirrjen e seancës duke shtuar këtu edhe kërkesat veç e veç për forcat politike në kuvend. Ata zgjodhën të heshtnin dhe të gjenin justifikime dhe deri me sot as nuk e thirren kurrë. Nga kjo kohë, OVL nuk parapëlqej fare qoftë nga qeveria qofte nga opozita e Kosovës, e aq ma shumë edhe nga ZPS-ja. U bëmë shënjestër e të gjithë atyre që donin të justifikonin votën e tyre. U bëmë edhe shënjestër e OJQ-ve dhe organizatave ndërkombëtare.
20. Është e rëndësishme të theksohet këtu se gjatë gjithë kësaj kohe dhe përkundër të gjitha kritikave publike ndaj dështimeve të DHS dhe ZPS-së për të respektuar standardet transparente të drejtësisë, zbatimin e barabartë të ligjit dhe funksionimin si institucion i Kosovës, asnjë person nuk erdhi asnjëherë për të më vizituar mua ose ndonjë anëtar të udhëheqjes së OVL-së për t'i diskutuar këto shqetësime. U injoruam.
21. OVL nuk donte të impononte dëshirat e tyre, por donte që të shqyrtohej ajo që ata kërkonin dhe më pas të bëhej një votim. Megjithatë nga opinioni ynë dhe

debatet tona te ndryshme ne media dhe veprimet e pashembullta dhe të pavend te ZPS-se, tek njerëzit filluan të ndikojnë dhe filluan te kuptohej e vërteta per ZPS-ne ku edhe filloi te ndryshoje opinionioni për DHS dhe ZPS-ne. OVL filloi të kuptoj se anëtarët e Parlamentit të cilët fillimisht kishin votuar për Gjykatën tani ndiheshin ne siklet dhe përpiqeshin të gjenin justifikime që që të mos fajësoheshin për autorizimin dhe krijimin e DHS. Tani thoshin se nuk e kishin ditur se ZPS do të bashkëpunonte ngushtë vetëm me Serbinë dhe me kriminelët çetnikë serbë, me po ata persona që ishin drejtpërsëdrejti të përfshirë në masakra të shumta në Kosovë dhe që kërkoheshin nga institucionet e Kosovës për gjykim. Kjo nuk duhej të ndodhte, përndryshe nuk do ta kishin votuar kurrë një sistem të tillë monoetnik dhe ndiheshin te mashtruar. OVL kërkonte vetëm një seance ku do diskutoheshin brengat tona dhe te opinionit qe mbretëronte ne Kosove, por kjo seance parlamentare nuk u thirr asnjëherë nga kryeparlamentarja Osmani edhe pse kushtet për një thirrje te tille ishin plotësuar edhe ne përputhje me Rregulloren e Punës se Kuvendit.

22. Qëndrimi i OVL-së së UÇK-së është se ne besojmë se DHS janë themeluar padrejtësisht, pasi që nuk i gjykojnë keqbërësit serbë dhe kanë në shënjestër vetëm pjesëtarët e UÇK-së. Kjo nuk është drejtësi. Autorët kryesorë të krimeve të luftës nuk akuzohen. Udhëheqësit ushtarakë dhe paramilitarë serbë përgjegjës për kryerjen e masakrave në mbarë Kosovën nuk janë hetuar. Kjo ka shkaktuar shqetësim të vërtetë rreth legjitimitetit të të gjithë procesit. Para se të bëhesha nënkryetar dhe zëdhënës i OVL-së së UÇK-së, si veteran qe isha unë isha i informuar për ankesat qe kishin veteranet qe ftoheshin nga ZPS. Veteranët me kishin informuar personalisht dhe vullnetarisht për këtë. Kjo kishte ndodhur diku që nga viti 2015. Raportohej se gjatë kësaj kohe ZPS kishin filluar të bëheshin më aktivë. Thuhej se ZPS po merrte në pyetje individë edhe brenda veturave te tyre gjate transportit, pa praninë e avokatëve. Po ashtu, raportohej se ZPS kishte filluar vitin e fundit të dërgonte ftesa përmes Viber dhe WhatsApp. Nuk mendoja se këto ftesa ishin legjitime, dhe isha i shqetësuar nga raportimet se ZPS kishte thirrur njerëz ne dy cilësime njëkohësisht si dëshmitarë dhe i dyshuar në të njëjtën kohë, gjë që e kam përshkruar më në hollësi më poshtë.

23. Kur ZPS filloi t'i thërriste njerëzit në këtë mënyrë, atëherë OVL, si organizatë, u kontaktua nga shumë anëtarë të saj. Anëtarët na lajmëronin ne ose e publikonin ne Facebook-un e tyre se janë thirrur në pyetje me telefon përmes Viber ose WhatsApp. Vetëm ata anëtarë që donin ta informonin OVL-në e bënë këtë dhe nuk është bërë kurrfarë presioni ndaj askujt.
24. Kur dëgjuam për këto metoda, që në fillim të vitit 2020, reagoi në televizion, për shembull kur isha në emision në T7 me një avokat, dhe e quajta këtë dukuri si problem i madh dhe i pa precedent. Thashë se në këtë mënyrë njerëzve po u bëhej presion i padrejtë dhe se veprimet e ZPS-së nuk dukeshin as njerëzore e as ligjore.
25. Me kohë (sidomos nga viti 2018 e tutje) bë e qartë se ZPS-ja po intervistonte individë në cilësinë e dëshmitarëve dhe më pas u thoshte atyre se tani po trajtoheshin si të dyshuar. Ata po quheshin "dëshmitarë/të dyshuar". Raportohej se disa ish-ushtarëve të UÇK-së ishin thirrur në këtë mënyrë. Kisha përshtypjen se ZPS po e bënte këtë për të ngjallur frikë te individët. Disa nga ish-ushtarët e UÇK-së mund të mos jenë të arsimuar. Shumica e tyre jetojnë në kushte të rënda ekonomike, do të thotë janë shumë të varfër dhe të papunë. Pra disa nga këta mund të jenë lehtë të cenueshëm dhe mund të manipulohen gjatë marrjes në pyetje, gjë që dukej se po e praktikonte ZPS duke shfrytëzuar cenueshmërinë e tyre.
26. Është e rëndësishme të kujtohet se që nga themelimi i DHS, udhëheqësia e mëparshme e OVL-se se UCK-se e kishin marrë vendim me 2015 që të mos bashkëpunonin dhe të mos u përgjigjen në asnjë mënyrë ZPS. Ky vendim është edhe i protokolluar.
27. Më 15 shtator 2017 u mbajt kuvendi i OVL-së, dhe në morëm drejtimin e saj diku ka fillimi i vitit 2020. Pasi kishim kritikuar publikisht metodat e përdorura nga ZPS në shumë raste, ZPS filloi ta ndryshojë qasjen. Ata u përpoqën të krijonin një precedent se ishin veteranët e UÇK-së ata që nuk po bashkëpunonin me hetimet e ZPS-së – duke mos u përgjigjur në thirrjet telefonike etj – por kjo thjesht nuk ishte e vërtetë. Mediat e paraqitën si fakt rastin e Remzi Shalës i njohur si "Molla e Kuqe". Për ne ishte ky ishte një precedent i krijuar artificialisht që ZPS-ja ta përdorte për t'i mundësuar të

procedonin me arrestime te pa paralajmëruara. Megjithatë, OVL dëshironte të shfrytëzonte çdo paraqitje publike (në televizion etj.) për ta paraqitur gjendjen e vërtetë. Si Hysni Gucati, ashtu edhe unë, bënim thirrje publike që kushdo që kontaktohet nga ZPS t'u përgjigjet thirrjeve të tyre dhe të mos bien në grackën që po përpiquej të na e montonte ZPS. Nga shtatori i vitit 2019, këtë e kisha thënë shumë herë në paraqitje të ndryshme në debate televizive në kanale të ndryshme, përfshirë televizionet: T7, Dukagjini, RTK e shumë media tjera. Besonim se mospërgjigja do të nënkuptonte se kishim frikën e ballafaqimit me drejtësi, përderisa nuk kishte arsye frike. Nuk donim që ZPS ta paraqiste një pasqyrë të rreme se gjoja - anëtarët tonë po arratiseshin apo nuk po bashkëpunonin.

28. Unë personalisht asnjëherë nuk jam kontaktuar apo kam pas ndonjë takim me oficeret ZPS-se para datës 17 shtator 2020. Po ashtu, asnjëherë dhe kurrë ne asnjë kohe mbas lufte nuk jam takuar me paraardhësit e kësaj ZPS-je, si UNMIK, EULEX apo SITF. Deri me sot, as edhe pas 16 muaj ne paraburgim, unë ende nuk jam intervistuar asnjëherë nga ZPS.

29. Shqetësimet e mia rreth DHS i kam bërë publike përafërsisht që nga fundi i vitit 2017. Nga ky moment e tutje, këto shqetësime i kam shprehur sa here jam paraqitur në panele me ekspertë dhe analist të shumtë të programeve televizive në shumicën e kanaleve kosovare –si p.sh. RTK, T7, TV Dukagjini etj, të cilat janë mediat kryesore me frekuence nacionale.

30. Duhet theksuar se publikisht dhe me ngulm e kam potencuar se nuk duhet te ketë përgjegjësi selektive dhe raciste, por të ndiqen penalisht te gjitha krimet dhe të jene llogaridhënës te gjithë ata qe kanë kryer krime kushdo qofshin ata serbë, shqiptarë apo te tjerë. Pra të gjithë përgjegjësit duhet të ndiqen penalisht. Dua të potencoj se ky ka qenë qëndrimi im që nga fillimi dhe ende kam ketë qëndrim. Unë nuk e kundërshtoj drejtësinë; përkundrazi e mbështes atë. Por vërtet e kundërshtoj padrejtësinë dhe kundërshtoj ndjekjet selektive dhe të njëanshme; kjo nuk është drejtësi dhe publiku në Kosovë kanë të drejtë të dinë nëse institucionet shtetërore të saj funksionojnë në përputhje me ligjin.

31. Kam bërë thirrje publike që ZPS të hetojë 460 masakrat e kryera nga serbët. Viktimat ishin të moshave të ndryshme nga foshnja te pleq. I përmendi këto

fakte sepse thjesht nuk ishte e drejtë. Krimet serbe nuk ndiqen nga ZPS-ja e cila nuk ka ndërmend të hetoje aty ku janë te implikuar serbët. Publiku ka të drejtë ta dijë këtë. Prandaj i kam përmendur me qindra herë këto krime, sepse dukej qartë që DHS nuk do të bënë asgjë. Doja që publiku ta dinte këtë, pasi një informacion i tillë është në interes të publikut. Veç kësaj doja që opinionit ti sqarohet dhe të kuptojë se DHS janë puro monoetnike dhe selektive.

32. Shqetësimi im i dytë rreth DHS është bashkëpunimi vetëm me Serbinë dhe atë konkretisht me vet ekzekutorët e krimit. Nuk do të kisha asnjë kundërshtim për bashkëpunimin me Serbinë nëse Serbia do të ishte tjetër nga ajo që është sot. Theksoj se Serbia edhe sot e kësaj dite nuk është distancuar nga politikat antishqiptare që kishte Milosheviqi. Edhe sot e kësaj dite, politika dhe qeveria serbe mohojnë krimet dhe masakrat që tashmë janë të njohura në mbarë botën – bile mohojnë edhe ekzistencën e Kosovës si shtet i pavarur e sovran. Kujtoj se fundmi mohimin e Masakrës së Reçakut, e cila masakër është denoncuar publikisht nga vetë Ambasadori W. Walker. Si mund të ketë bashkëpunim me Serbinë pra?

33. DHS janë monoetnike dhe ZPS duan vetëm të ndjekin krimet e supozuara të kryera nga UÇK-ja. Nëse janë kryer krime, a nuk ka qenë e mundur që dikush që nuk ishte pjesëtar i UÇK-së t'i kryente këto krime? E gjithë Kosova nuk janë ish pjesëtarë të UÇK-së.

34. Pas zbulimit të dokumenteve të rrjedhura të ZPS, shqetësimet e mia arsyetoheshin nga fakti që ZPS kanë bashkëpunuar me vet kriminelë lufte, kanë hapur hetimet e tyre bazuar në të dhënat e po këtyre ekzekutorëve dhe në baze të hetimeve që paraprakisht ishin udhëhequr nga [REDAKTUAR] dhe kryeprokurori serb Vladimir Vukcevic – diçka që doli në shesh dhe u konfirmua, edhe nga dosjet dhe dokumentet e rrjedhura, nëse vërtetohen, nga vet këto dhoma.

35. Megjithatë, rrjedhjet zbuluan një problem edhe më të madh - rrjedhja e dokumenteve të ZPS-së tregon, sërish nëse vërtetohet autenticiteti i tyre dhe nëse vërtetohet kanë dalë nga ZPS, një nga dy gjërat. Së pari, se dikush në ZPS kishte nxjerrë me dashje dokumentet. Së dyti, se ZPS kishte pësuar një shkelje aq të rëndë të sigurisë sa që minon vetë qëllimin e themelimit të saj jashtë

Kosovës. Ishte kjo rrjedhja, qoftë e qëllimshme ose pas një shkeljeje të sigurisë, që kishte shkaktuar shqetësime. Ende nuk dihet sa ka qenë rrjedhja dhe ka shumë mundësi që dokumente t'u jenë dhënë edhe personave të tjerë. Kjo tani u bë shumë shqetësuese jo vetëm pse këto dosje nuk mbrojtën askënd, por aty u mor vesh se edhe vet hetimet e tyre mbështeteshin në të dhënat e siguruar nga zyrtarë serbë të përfshirë në kryerjen e krimeve të luftës.

36. Veçse dihej publikisht se dosjet e hetimeve dhe proceseve gjyqësore të mbajtura nga prokurorët në Kosovë u dorëzoheshin në të njëjtën kohë organeve dhe prokurorisë serbe, duke ekspozuar kështu dëshmitarët dhe viktimat kosovare. Këto informata veçse ishin bërë publike që nga koha e kryeprokurorit italian në Kosovë, Salustro – prokurori i parë që dihej se kishte bashkëpunuar me serbët. Veç kësaj, kuptova se ai kishte bashkëpunuar me hetuesit dhe prokurorët serbë dhe më vonë ishte zhvendosur në Beograd si këshilltar i institucioneve serbe, siç u bë publike edhe nga gjyqtari i EULEX-it Malcolm Simmons dhe ish-prokurorja e EULEX-it Maria Bamieh. Këto i kam ditur shume para Shtatorit të vitit 2020 andaj mendoja se këto informata ishin tashmë të njohura për publikun. Dyshimet e mia për të ashtuquajturat institucione të drejtësisë, përfshirë ato të EULEX-it, e jo vetëm, ishin të bazuara mirë. Këto zbulime nga rrjedhja e dokumenteve të ZPS vetëm kanë shërbyer si provë se ZPS-ja thjesht ka ndjekur rrugën e njëjtë si SITF dhe EULEX.

37. Qëndrimin tonë ndaj DHS/ZPS e shprehim hapur. Siç përmendet më lart, në biseduam me grupet parlamentare për përfundimin e mandatit të DHS në qershor të vitit 2020. Ne mendonim se mandati i DHSK-së do të përfundonte në gusht të vitit 2020 dhe kërkuam sqarime për këtë. Këtu nuk ka asgjë të paligjshme. Ne iu drejtuam atyre në mënyrën më demokratike të mundshme. Asnjëherë nuk kemi pasur qëllim që të gjejmë mënyra për të bllokuar punën e DHS/ZPS. Synimi ynë ka qenë të përpiqemi të ndryshojmë ligjet ekzistuese që kanë të bëjnë me DHS/ZPS ose ta shfuqizojmë atë. Nëse shfuqizimi nuk do të funksiononte, atëherë së paku do të përpiqeshim të ndryshonim DHS/ZPS për t'u siguruar që DHS/ZPS t'i ndiqnin të gjitha krimet, përfshirë ato të kryera nga serbët apo edhe të tjerët. Kjo është ndryshe nga përpjekja për ta bllokuar atë.

Nuk kam pasur kurrë asnjë qëllim që ta pengoj drejtësinë. Përkundrazi, kam përkrahur drejtësinë për të gjithë.

Në lidhje me interesin publik

38. Është në interesin publik në Kosovë për të ditur dhe kuptuar se si funksionojnë institucionet e saj të drejtësisë, veçanërisht në lidhje me marrëdhëniet e saj me Serbinë. Kjo është temë shumë e dhimbshme për të gjithë ne në Kosovë. Shumë familje kanë vuajtur nga shtypja serbe. Ishte e paimagjinueshme të sugjerosh se po ata shtypës serbë po drejtojnë prokuroritë dhe po japin dëshmi të rreme.
39. Unë nuk jam vetëm një banor i rëndomtë që rastësisht kam ardhur në krye të OVL-së. Prandaj nga unë është pritur ta bëja atë që kam bërë. Jam person i përfshirë në të gjitha rrjedhat dhe zhvillimet patriotike për lirinë e vendit tim me përvojë prej 45 vitesh i rritur neper sakrificave familjare dhe individuale dhe me formim të plotë të jetës politike. Mund të mos kem pas ndonjë post të lartë qeveritar e institucional, por kam qenë pjesë e iniciativave dhe veprimeve politike për të mirën e vendit tim. Kam qenë gjithmonë i gatshëm të sakrifikoj për të mirën e popullit tim - kurrë nuk kam qenë në kërkim të kurrfarë përfitimi personal.
40. I përkas një familjeje ku secili brez betohet para varreve të paraardhësve se do të bëjnë gjithçka që është e nevojshme për mbrojtje të ligjshme të vendit të tyre. Për shembull, djali im Gurakuqi i lindur dhe rritur në Suedi i mbështetur edhe nga motrat dhe vëllai e familjarët e tjerë, është kthyer nga Suedia, dhe aktualisht shërben në ushtrinë e Kosovës. Ai ka shkuar te varri i gjyshërve dhe aty u betua se do të vazhdojë të njëjtat aktivitete për mbrojtje të vendit dhe kjo dëshmon se kjo është tradita dhe krenaria jone familjare sepse çmojmë lirinë.
41. Në fund të fundit, ndonjë rast i izoluar, qoftë edhe pjesëtarë nga UÇK-ja, duhet të hetohet nga DHS për ndonjë krim të pretenduar gjatë luftës në Kosovë. Megjithatë, këtë do ta shihja si të drejtë vetëm atëherë kur e njëjta ZPS do t'i hetonte e gjykonte kriminelët tani veç të ditur nga pala tjetër e luftës. Vetëm atëherë kjo do të ishte barazi para ligjit dhe me standarde të njëjta.

42. Në maj të vitit 1998, kur filloi lufta, ushtria çetnike serbe hynë në fshatin Lubeniq te Pejës dhe kësaj radhe i pushkatuan gjashtë civilë. Po ashtu ne muajin prill të vitit tjetër, pra me 1999, prapë po në këtë fshat Lubeniq, hyn dhe zbrazen fshatin nga të gjithë banoret dhe i detyruan të nisen në këmbë për në Shqipëri ku nga kjo turme, ata veçuan diku 61 persona dhe i ekzekutuan. Mes tyre kishte burra, gra, të moshuar dhe foshnja, dhe më vonë disa u dogjën të gjallë në shtëpitë e tyre. Janë të dokumentuara edhe shumë dëshmi të protagonisteve okularë që kanë dhënë përpos emrave të oficerëve policorë edhe disa emra të banoreve serbë e romë, banorë të po këtij fshati, të cilët i kanë përzgjedhur disa individë për t'i ekzekutuar. Këto dëshmi janë dhënë edhe në UNMIK dhe po ashtu edhe në EULEX, por asgjë nuk është hetuar. Po ashtu edhe zhdukja e profesorit Ukshin Hoti e ku kohëve të fundit të këtij viti, pati një rrëfim autentik nga një pjesëtar i njësisë vrastare serbe ku shpjegoi në një televizion serb ku deklaroi se: *Ukshin Hotin e kanë arrestuar, sapo është liruar nga burgu i Dubraves dhe e kanë sjelle po në fshatin Lubeniq ku e kanë ekzekutuar duke ja vene trotilin në kokë.* Të gjitha këto ngjarje duhet të bien edhe në mandatin kohorë të ZPS-se, dhe disa nga këta kriminel edhe janë banorë të Kosovës, por megjithatë, asnjë nga këta apo këto ngjarje nuk duket se janë objekt akuze nga ZPS.

43. Këto ngjarje në Lubeniq por edhe ato në Drenice, Llap, Llapushe, Rahovec, Krushë e vogël, Meje e ane e mbanë Kosovës, janë të përshkruara në shtypin e kohës së luftës sipas porosisë dhe detyrave që kishte marrë nga vet Millosheviqi Koordinator i tashëm i ZPS-se [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR] dhe vartësit e tij, si përshkrime juridike merrte instruksionet nga kryeprokurori për krime lufte gjithashtu edhe ky tani një bashkëpunëtor kryesor i ZPS-se pra Vladimir Vukcevic. Këto masakra i arsyetonin me atë se ishte reagim i ushtrisë Serbe pasi ata ishin sulmuar diku në rrugëtim e sipër.

44. Kjo gjykatë është dashur të bëjë përpjekje për t'i marrë edhe këto informacione nga koordinatori i saj dhe qeveria serbe, por shihet qartë se edhe nga kërkimi i informatave ka qenë selektive dhe diskriminuese. Pse nuk i thërret ZPS edhe serbet dhe nacionalitetet tjera të Kosovës që fshihen në Serbi dhe t'i intervistojnë edhe ata? Si qytetarë të Kosovës mund t'i sjellin në Hagë nëse nuk kanë fakte, atëherë mund të mbledhin prova; kanë pasur vite për ta bërë këtë,

megjithatë ose kanë dështuar ose refuzuar ta bëjnë këtë. Duhet shtruar pyetja pse.

45. ZPS vetëm dëshiron të na ndëshkojë neve. Për shembull, ZPS as që po na dëshmon se si dhe kush na e sjelli materialin në OVL. Ndërsa me ngulm kërkojnë që ne të dënohemi. Por prapë se prapë këta duan të na persekutojnë neve duke kërkuar të dënojnë kryetarin dhe nënkryetarin e OVL-se. Kam pasur dhe ende kam përshtypjen se kam pas si detyre të ndaj këtë informacion për hirë të interesit publik dhe njerëzit që ne i përfaqësonim. Populli i Kosovës filluan të na besojnë dhe të konkludonin se DHS ishin vërtet një gjykatë mono-etnike. Kur u bë rrjedhja e dokumenteve, OVL konsideronte se duhej t'i publikonim dokumentet në interes të publikut. Nëse vetëm do ta informonim publikun se kishte një rrjedhje, atëherë OVL e dinte se do të akuzoheshim për falsifikim ose fabrikim të dokumenteve. Publiku kishte interes të dinte shkallën e bashkëpunimit me kriminelët serbë të luftës.

Faktet Materiale

Zbulimi i parë

46. 7 shtatori 2020 ishte ditë e hënë. Të hënave, zakonisht si fillim i javës në mbledheshim në zyrën e kryetarit dhe ndanim punët e javës dhe dikur në atë kohë arritën dokumentet (zbulimi i parë). Kjo dërgesë njihet si "Rrufeja 1" dhe mbërriti në mes orës 10:00 - 10:30.

47. Në momentin që mbërriti dërgesa, isha në zyrën e z. GUCATI së bashku me Faton KLINAKUN dhe Cele GASHIN.

48. Taibe MIFTARI hyri me furi në zyrë dhe na tregoi të gjithëve brenda se dikush kishte ardhur dhe kishte lënë një pako dhe ishte larguar menjëherë. E pyeta se kush ishte, ajo tha se personi që kishte lëshuar dokumentet kishte thënë disi kështu: "këto janë për atë personin që flet në televizion". Kështu nënkuptonte se aludohej në mua me që se unë edhe kisha detyrën e zëdhënësit të OVL. Ishte diçka befasisëse. Taibja na tha se burri që kishte sjellë pakon mbante syze dielli, maskë në gojë dhe një kapele bejsbolli.

49. Taibe Miftari ishte shumë e tmerruar nga e gjithë ngjarja. Unë dhe të tjerët te pranishëm dolëm në korridor ku ishte pakoja, sepse donim të shihnim se çfarë ishte. Taibja ishte e shqetësuar dhe tha "jo, jo, jo, mund të ketë ndonjë send brenda dhe aludonte ne bombe, sa mund bërtiste mos e prekni!". Të gjithë ishim të shqetësuar, ju kam ofruare dhe me sa me kujtohet, Hysniu apo dikush tjetër me thoshte mos e prek njëherë. Edhe unë kisha shqetësimin që mund të kishte diçka të rrezikshme. Njëri nga burrat (nuk më kujtohet saktësisht se cili) e kapi kutinë dhe e hoqi nga tavolina në korridor dhe e dërguan në zyrën e Hysniut dhe filluam të shihnim se çfarë ishte ajo dërgesë. Nuk kishte asgjë të shkruar në pjesën e jashtme të pakos - ajo thjesht ishte e mbyllur. Gjerësia e pakos ishte e përafërt me formatin A4 dhe kur e hapëm kuptuam se brenda kishte katër stoqe letrash që nuk ishin të lidhura. I nxorëm dokumentet jashtë dhe pakon e zbrazur e futëm nën tavolinë.
50. I nxorëm letrat nga pakoja, i vendosën mbi tavolinë dhe vlerësuam se çfarë ishin. Asnjëri prej nesh nuk e kishte idenë se kush ishte prapa kësaj dhe nga erdhi kjo dërgesë? Prandaj për këtë arsye nuk e kishim idenë fare se çfarë ishin këto dokumente.
51. Atëherë i shpërndamë në tavolinë me tufa ashtu siç ishin në pako të vendosura 1-2-3 etj, dhe kemi filluar t'i kontrollojmë se çfarë përmbanin. Së pari, donim të shihnim nëse ishin të gjitha njësoj, apo të ngjashme, por kur e shikuam faqen e parë dhe i krahasuam me të tjerat, ato nuk ishin të ngjashme. Të gjithë ishim të përfshirë në kontrollimin e këtyre letrave - unë po kontrolloja një grumbull letrash dhe të tjerët e pranishëm (si: Fatoni etj) po kontrollonin grumbujt e tjerë të letrave. U kërkova të tjerëve të mos i ngatërronin letrat. Pas një rishikimi të shpejtë për të krahasuar letrat, për aq sa mundëm, dukej se grupet e dokumenteve kishin përmbajtje të ngjashme.
52. Në atë moment ne si kryesi e ngushte morëm vendim të thërrisnim konferencën për shtyp. Arsyet për thirrjen e konferencave për shtyp ishin (1) për të qenë transparent në lidhje me rrethanat e dërgesave (2) për të lejuar shtypin/mediat të shihnin se çfarë kishim marrë dhe për të konfirmuar përmbajtjen e dokumenteve (3) t'ia linim shtypit/mediave të bënin çfarë e mendonin më së miri me ato dokumente, duke përdorur gjykimin e tyre

profesional, dhe (4) për të treguar se DHS/ZPS po bashkëpunonin me autoritetet serbe, respektivisht me ata që ishin të përfshirë në shumë masakra në Kosovë. Kjo ishte e rëndësishme sepse në kohën e themelimit të Gjykatës, si Gjykata ashtu edhe Qeveria e Kosovës i thanë publikut se Gjykata nuk do të bashkëpunonte me autoritetet serbe. Në vitet 2014 dhe 2015, publikut iu tha se Dhomat e Specializuara do të themeloheshin si një dhomë e veçantë e Kosovës dhe do të hetonin disa raste. Atëherë ne, OVL e UÇK-së, e kuptuam (ndoshta me vonesë) se Gjykata do të hetonte vetëm UÇK-në. Më pas kemi kërkuar që të krijohet një gjykatë vendore nën mbikëqyrjen ndërkombëtare për të ndjekur penalisht të gjitha krimet e kryera në Kosovë pasi që filloj të shihet qartë se ZPS-po vepronte njëanshëm dhe selektivisht. Ishte në interesin publik të informonim se çfarë na ishte sjellë.

53. Kur erdhën gazetarët, pyetën se çfarë përmbanin letrat. U thamë se mendonim se të gjitha letrat dukeshin të ngjashme. Por pa dyshim, kjo bazohej në atë që kishim mundur të kontrollojmë deri në atë moment, sepse realisht nuk kishim mundur t'i kontrollojmë të gjitha 1000 faqet që ishin aty (4 grupe dokumentesh, secili dëng përmbante rreth 1000 faqe). Besonim se kishim katër kopje të dokumenteve të njëjta, megjithëse nuk mund të ishim të sigurt për shkak të kohës së shkurtër dhe se shumë nga dokumentet ishin në një gjuhë që ne nuk e kuptonim mirë.

54. Siç u përmend më herët, në vitin 2015 ka pasur një vendim të protokolluar të Kryesisë së atëhershme të OVL-së, që urdhëronte veteranët të mos përgjigjen në asnjë ftesë që mund të marrin nga ZPS-ja dhe në asnjë mënyrë të mos bashkëpunojnë me ta. Mirëpo ne u kërkuam veteranëve të paktën t'u përgjigjen thirrjeve të ZPS-së, vetëm e vetëm që të parandaloheshin skenarët e arrestimeve të dhunshme dhe spektaklet dhe kapja e njerëzve në rrugë e gjetiu. Andaj, në përputhje me këtë vendim të mëparshëm, nuk e kemi menduar që t'i thërrasim drejtpërdrejt pasi kjo mund të krijonte përshtypje të gabuar dhe ka qenë sjellja e vetë ZPS-së që ka bërë çuar të marrja e këtij vendimi. Prandaj vendosëm t'i thërrasim në mënyrë indirekte përmes mediave pasi një veprim i tillë ishte në interesin publik. Më shqetësonte mospërfillja dhe indiferenca totale e ZPS-se. Sepse vet mbërritja e këtyre dokumenteve ishte një ngjarje e jashtëzakonshme

dhe një shqetësim publik, se si një material i tillë përfundoi në zyrat tona, se kjo po i ngjante një kurthe për ne.

55. Pastaj mbajtëm konferencën për shtyp rreth orës 13:00, e cila u transmetua drejtpërdrejt. Gjatë konferencës për media, kam njoftuar Policinë e Kosovës, Prokurorinë Speciale të Kosovës dhe ZPS-në e Hagës, se po ruaja një kopje të dokumenteve për ta, në mënyrë që të mund të shihnin se çfarë janë dhe se isha në pritje të shpjegimit. Prandaj e konsideroja këtë si ftesë shumë publike për këto organizata – edhe pse vendosa që të mos e thërrisja drejtpërsëdrejti ZPS-në.
56. Isha shumë i zhgënjyer me ZPS-në dhe duke thirrur konferencën për shtyp në i ftonim shtypin të vinin dhe të shihnin saktësisht se çfarë po bënte ZPS-ja, dhe të sqaroheshin. Ftesën për mediat e ka dërguar me email Faton Klinaku.
57. Në konferencën për shtyp, të pranishëm ishin mbi 25 gazetarë. Konferenca për shtyp zgjati rreth 30 minuta. Ne e kishim materialin para vete në tavolinë gjatë konferencës për shtyp dhe gazetarët afroheshin i shfletonin, fotografonin dhe komentonin me njeri tjetrin. Nuk kam përmendur identitetin e dëshmitarëve apo individëve dhe nuk kam folur për provat që këta persona mund t'i kenë dhënë. Asnjë emër serb nuk është përmendur për sa u përket dëshmitarëve. Gjithçka që kam bërë ishte të përmendja komunikimin ndërmjet SPO-së dhe institucioneve në Serbi dhe të përmendja me emër zyrtarët e njëjtë serbë që ishin njerëz publikë në poste publike në Serbi.
58. Kishte përfaqësues nga disa agjenci të lajmeve Kosovare duke përfshirë: RTK, Kosova Press, T7, Ekonomia Online etj. Agjencia e Lajmeve Kosova Press i ka të gjitha të incizuara.
59. Gazetarët kishin vendosur të vinin dhe të merrnin nga një kopje të dokumenteve – secili për vete. Thash se do ta ruaja një kopje për ZPS-në dhe do ta lija mënjane. Më kujtohet të kem folur me Halil Berishën në atë kohë. Ai ishte i pari që erdhi dhe kërkoi një kopje. Gazetarët tjerë protestuan. Filluan të merrnin kopje nga grumbulli i tretë. Më pyetën nëse kishte kopje të tjera. Thashë

se nuk kisha më kopje vetëm nga këto që janë sjelle, e as që do të bënim ndonjë kopje.

60. Nuk e pranoj atë që thotë Halili në deklaratën e tij – unë nuk i kam kërkuar t'i bëjë kopjet për gazetarët e tjerë.
61. Grupi i dokumenteve të rrjedhura që kishim pranuar përmbante katër kopje të dokumenteve – një e rezervuam për ZPS-në dhe një të cilën e mori Halili. E dy te tjera u morën nga gazetarët.
62. Të gjithë ishin të interesuar të merrnin sa më shumë dokumente për të dalë vetë të parët me lajmin. Të gjithë gazetarët ishin shumë të ngazëllyer e te habitur për daljen e një materiali të tillë. Ne media dëgjuam se ZPS kishin thirrur të gjitha mediat atë mbrëmje kur e panë lajmin në televizion për ta qetësuar situatën. Redaktorët që i bënë publike dokumentet – e bënë këtë me iniciativën e tyre dhe vullnet të lirë.
63. Mendoj se deri në orën 14:00 nuk kishte mbetur askush në dhomë. Ndoshta zyra ishte ende e hapur deri në orën 16:00.
64. Pak kohë pas konferencës për shtyp, shkova në Shqipëri për pesë ditë, por vazhdoi të kishte shumë presion përmes telefonit – shumë gazetarë kërkonin kopje. U thash se ne Zyrat tona nuk kishte mbetur asnjë kopje dhe u sugjerova t'i drejtoheshin Halilit.
65. Për pushime në Shqipëri kam shkuar se bashku me djalin, nusen dhe fëmijën e tyre, pasi që këta na e kishin parapaguar pushimin.
66. Nga mediat kuptova se ZPS kishte kontaktuar Sekretarin e OVL-se, Faton Klinakun, për të marrë kopjen e atyre dokumenteve. Fatoni ne cilësinë e sekretarit u kishte thënë se sipas vendimit që kishim marrë se bashku ne, nuk do t'ua jepte dokumentet ZPS-së para se të përfshihej Prokuroria e Kosovës apo policia e Kosovës dhe kishte ftuar ZPS-në që të vinin të nesërmen.
67. Dikur nga mbrëmja më thirri Faton Klinaku dhe Cele Gashi dhe më njoftuan se z. Gucati kishte urdhëruar Fatonin që t'i jepte ZPS-së kopjen e dokumenteve dhe se Fatoni kishte vepruar ashtu. Unë nuk pata ndonjë kundërshtim për këtë.

68. Duhet theksuar këtu se pas pranimit të dokumenteve nuk është kryer asnjë kontroll i objektit nga ZPS.

69. Jam kthyer nga pushimet në Shqipëri të dielën më 13 shtator 2020. Për pesë ditët sa isha në pushim, askush nga ZPS, policia apo prokuroria vendore nuk më kanë kontaktuar.

Zbulimi i dytë

70. Të mërkurën, më 16 shtator 2020, nga ora 09:30 – 10:30, grupi i dytë i dokumenteve mbërriti në OVL. Kjo njihet si “Rrufeja 2”. E mërkura e 16 shtatorit ishte ditë pune. Taibja na informoi se kishte parë një person të maskuar duke dorëzuar një pako dokumentesh. Kur kishte ndodhur kjo, isha në zyrën e Hysniut se bashku me Fatonin dhe Faik Fazliun. Taibe hyri në zyrën e Hysniut dhe tha: "Erdhi edhe një paketë". Në këtë moment, Fatoni doli me shpejtësi nga zyra dhe më von mora vesh se kishte tentuar ta ndiqte personin që kishte sjellë dërgesën përderisa dilte nga ndërtesa.

71. Nuk e kam parë Fatonin ta ndiqte atë burrin, por kur u kthye, Fatoni na tregoi mua, Hysniut dhe te tjerëve te pranishëm aty se ju kishte afruar dorëzuesit në shkallë. E pyeta Fatonin pse e kishte bërë këtë; isha i shqetësuar pasi mund të ishte e rrezikshme. Fatoni u përgjigj se kishte dashur të provonte dhe të zbulonte se kush ishte dërguesi.

72. Pas dorëzimit të dytë, më kujtohet se i jemi drejtuar Policisë së Kosovës për t'u kërkuar ndihmë dhe mbrojtje sepse kishin parë lloj-lloj aktivitete të pazakonshme nga vetura të panjohura e të çuditshme, por nga ta nuk morëm kurrë përgjigjeje e as nuk pamë ndonjë veprim.

73. Pas zbulimit të parë, OVL thirri një mbledhje për të vendosur se çfarë të bënte në rast se kishte ndonjë zbulim tjetër. Ishte vendim unanim që të bënim publik çfarëdo zbulimi të mëvonshëm që do të dorëzohej. Kështu, pas zbulimit të dytë u thirr konferenca për shtyp në sallën e konferencave të OVL-se, në katin e epërm, diku në orën 11:00 – 12:00. Këtë herë erdhën edhe më shumë gazetarë – salla ishte plot me gazetarë. Më kujtohet të kem parë mikrofonat që përfaqësojnë të gjitha agjencitë kryesore mediatike. Nuk e kam vërejtur nëse

Halil Berisha ishte i pranishëm apo jo. Thjesht nuk më kujtohet. Por edhe nëse ishte aty, nuk jam i sigurt se do ta kisha njohur. Më shumë i njoh moderatorët e televizioneve sesa gazetarët individualë.

74. Kurrë nuk e kam pasur numrin e telefonit të Halil Berishës te regjistruar ne phonebook. Ka ndodh qe gazetarët e tjerë që donin ti marrin materialet nga ai dhe ma kanë kërkuar numrin e telefonit të Halilit.
75. Ne pakon e dyte me duket se ishin tri kopje te njëjta por me te crregullta ne renditje. Pako e dytë ishte më e vogël se pakoja e parë. Ishte ndoshta diku sa gjysma e madhësisë së paketës së parë. Sipas vlerësimit tim kishte rreth 300 - 400 faqe – ndërsa e para duhet të ketë pasur 800 – 1200 faqe. Megjithatë, është e vështirë të thuhet pasi faqet nuk ishin të palosura sipas radhës dhe sigurisht as qe e di saktësisht se nuk i numërova faqet.
76. Këto letra përmbanin dokumente me emrin e Kryeprokurorit të atëhershëm Clint Williamson. Kishte edhe shumë komunikime me autoritetet serbe. Si dhe koordinatorin [REDAKTUAR] dhe Vladimir Vučković. Kishte edhe letra falënderimi për bashkëpunimin ndihmues. Ne kaluam shkarazi nëpër dokumente dukeshin te se njëjtës natyre dhe kështu nuk u kushtuam shumë vëmendje.
77. Nuk kishte shumë kohë për ardhjen e mediave – ndoshta vetëm rreth një orë e gjysmë. Por pavarësisht njoftimit të shkurtër, shumë gazetarë erdhën. Ata kishin hamendjet dhe dyshimet e tyre (pasi që kishte të bënte me një zbulim të dytë), por erdhën sërish. Dola në programe të shumta televizive me gazetarë dhe e dija që ata kishin këto mendime.
78. Kjo konferencë për shtyp ishte e shkurtër dhe zgjati vetëm rreth 30-40 minuta. Gazetarët kishin disa pyetje. Çdo gjë është e incizuar.
79. Të gjithë gazetarët morën kopje të dokumenteve. Këtë herë askush nuk më pyeti nëse mund të merrnin një kopje. Edhe një herë, shkresat përbëheshin nga tri kopje të grupeve të dokumenteve. Përmbajtja e këtyre dokumenteve ishte në anglisht, shqip dhe serbisht.

80. Kur mbaroi konferenca për shtyp, unë, Hysniu Fatoni zbritëm poshtë, ndërsa gazetarët qëndruan edhe pak në sallë.
81. Fatoni më tregoi më vonë se [REDAKTUAR], një hetues i ZPS-se në Kosovë, kishte telefonuar Faton Klinakun në mbrëmjen e datës 16 shtator në ora 18:15 dhe Fatoni kishte thënë se ishte shumë vonë që ZPS të vinte në OVL, por se ata mund të vinin të nesërmen në mëngjes. Sigurisht se ZPS po të kishte dashur, mund të kishin insistuar të vinin atë mbrëmje, por dukej se nuk e kishin për ngutë.
82. Po të kishte dashur ZPS-ja, mund të siguroheshin që askush të mos hynte apo të dilte nga ndërtesa deri të nesërmen. Do ta mbronin ndërtesën dhe do të dërgonin policinë që të qëndronte atje deri të nesërmen në mëngjes. ZPS i kanë pasur të gjitha mjetet e nevojshme, policinë dhe burimet, por nuk e kanë bërë kurrë këtë. Është pyetje e arsyeshme të pyesësh pse.
83. Të nesërmen, të enjten më 17 shtator 2020, rreth orës 09:50, ZPS mbërriti në OVL. Ky ishte momenti kur u takova për herë të parë me [REDAKTUAR] ai erdhi lartë në restorant. Isha i ulur duke përdorur qaj. Erdhi i mbushur frymë dhe merrte frymë përmes një maske. Nuk e dija kush ishte. [REDAKTUAR] mezi po merrte frymë sa që mendova se mund të pësonte infarkt. Personi mu drejtua mua dhe më pyeti se kush isha, unë ju përgjigja: "Unë jam Nasim Haradinaj. Çfarë dëshironi?". Ai me tha: "A do të ishte e mundur të flisja me ty?" dhe unë thashë "po, por kush je ti". Ai shpjegoi se ai ishte [REDAKTUAR] nga ZPS-ja dhe ma tregoi distinktivin e tij. Më pas shkuam nga restoranti drejt zyrës së Hysniut pasi ai kishte kërkuar një takim privat. Më fliste shqip.
84. Shkuam në zyrë të Hysniut dhe ata kërkuan që një herë të i shikonin se a janë apo nuk janë materiale të tyre. Shkuam dhe i vizituam sallën e konferencave të OVL me Daniel Moberg (zyrtar suedez i sigurimit të ZPS-së) dhe me një njeri i quajtur ([REDAKTUAR]), i cili tha se ishte vëzhgues. [REDAKTUAR] fliste rrjedhshëm shqip.
85. Në atë kohë në dhomë ishte i pranishëm Milaim Zeka (gazetar) dhe filloj të incizojë me telefon, ndërkohë që edhe zyrtari suedez po incizonte me telefon, deri sa ky incizonte [REDAKTUAR] kërkoi që takimi të mos incizohet nga

askush. Atëherë Milaimi e vendosi celularin në tavolinë gjatë takimit. Unë kundërshtova sepse thashë se nëse ata po incizonin me telefon pse te mos incizonim edhe ne. [REDAKTUAR] më siguroi se as zoti Moberg nuk po incizonte.

86. Megjithatë, kisha përshtypjen se Daniel Moberg ishte duke incizuar edhe një kohe te shkurtër – të paktën fillimin.

87. [REDAKTUAR] tha se kishin dëgjuar se disa materiale të ndjeshme kishin arritur në OVL. I thashë se ju ishit më herët për t'i marrë disa tjera por nuk kthyet kurrë përgjigjeje se ato ishin material i ndjeshëm. [REDAKTUAR] më tregoi se i kishin treguar Fatonit. Fatoni e kundërshtoi këtë duke i treguar vetëm dy letra; një autorizimin e personave për sekuestrim dhe një flete dëshmi për pranim dorëzim. [REDAKTUAR] tha se si fillim vetëm dëshironte për t'i parë ato dhe te vlerësonte se a ishte apo nuk ishte material për ta.

88. Isha i zemëruar pasi që nuk sqaruan pasi kishin marrë materialet e pare se a ishin dosje te tyre – përkundrazi tha se do ti shikonin “Do t'i kontrollojmë nëse janë materialet tona.” U përgjigja duke thënë se: “Sa i përket dërgesës së parë, nuk na keni dhënë asnjë përgjigje se te kujt ishin dokumentet, por edhe nëse mendoni se janë tuajat, dëshirojmë t'i dorëzojmë këto materiale në prani të avokatit apo policisë së Kosovës. Ai u përgjigj: “Shiko, policia nuk do të mund të vijë as për një muaj. Mund t'i lë këtu, dhe policia nuk do të mund të vijë” “Pse jo?” Pyeta. “Sepse nuk guxojnë të vijë këtu pa marrë udhëzimin e ZPS-së”, tha ai.

89. Thashë ne po e thërrasim avokatin e OVLse dhe e thirra Tome Gashin. Tome GASHI është një avokat, i njohur dhe fytyrë publike dhe normalisht se kisha dëgjuar për të në vitet e nëntëdhjeta. U takova me të dhe i propozova që ta angazhonim pro bono për të përfaqësuar OVL-në dhe Hysni GUCATI nënshkroi kontratën.

90. Në atë kohë, z. Gashi tha se ishte në një seancë gjyqësore por sapo ta kryen do vij direkt. Përderisa prisnim që z. Gashi të mbërrinte, [REDAKTUAR] tha: “A nuk do të ishte e mundur ta shikojmë materialin? Dhe nëse zbulojmë se nuk

janë tonat, atëherë nuk kemi nevojë t'i marrim." Ashtu edhe vepruam u ngjita lart me ta. Mori dokumentet dhe filloi t'i kontrollonte.

91. Kur [REDAKTUAR] filloi të i kontrollonin të tri grupet e dokumenteve dhe në fillim me shprehje duke shfrytëzuar nga buzët tregonte sikur nuk janë të rëndësishme dhe tha: “nuk ka asgjë interesante për ne”.
92. Pastaj bashkë me [REDAKTUAR] u kthyem poshtë dhe thashë: tani çfarë do të bëni? Do t'i marrësh dokumentet, apo të presim të vijë avokati?” Më pas u përgjigj duke thënë se do të presin deri sa të vinte avokati. Kur Tome Gashi mbërriti rreth orës 12:30, ai e pyeti [REDAKTUAR], "pse nuk keni vendosur ende se çfarë do të bëni me materialin?" – [REDAKTUAR] iu përgjigj duke thënë se do të merrte dokumentet. Unë pastaj i thashë: “Në rregull, tani duhet të thërrasim Gjykatën tonë dhe policinë.” [REDAKTUAR], u përgjigj: “Të thashë se nuk do të vijmë”. Në atë rast, Toma tha se nuk kishte rëndësi, duke mu drejtuar se pse nuk po ua dorëzoni. “Unë jam avokati i juaj dhe mund t'i dorëzosh, le t'i marrin pasi që po thotë se janë të tyre”. Me këshillën e Tomë Gashit, e lejuam [REDAKTUAR] të merrte dokumentet.
93. U ngjitem lartë dhe [REDAKTUAR] futi dokumentet nën krah dhe zbriti në katin e poshtëm. Nuk mu duk aspak zyrtarë – nuk i vuri shumë rëndësi rëndësi vetëm sa mblodhi gjithçka dhe i vuri nën krah dhe i çoi në zyrën e Hysniut. Ai nuk bëri ndonjë shënim se sa faqe morën ose çfarë përmbanin. Ai nuk i futi në ndonjë zarf të mbyllur, por vetëm i futi në një çantë shpine.
94. Prita derisa Hysniu nënshkroi një fletë-dorëzim – s`më kujtohet se a mund ta ketë nënshkruar edhe Toma. (Kam parë të nesërmen vetëm fletëdorëzimin që Hysniu kishte nënshkruar). Hysniu pastaj i pyeti zyrtarët e ZPS nëse donin kafe dhe ata pranuan dhe i pimë se bashku. Ne patëm krejt një takim të relaksuar me ZPS-ne dhe u krijua një ambient i ngrohtë dhe shumë miqësor e njerëzor.
95. Biseda ime e vetme me Daniel Moberg ishte kur folam suedisht me të – për t'u siguruar që ishte vërtet suedez. Nuk i besova në fillim, sepse nuk dukej si suedez dhe nuk e hiqte maskën për mbrojtje nga COVID. Por kur e dëgjova duke folur mirë suedisht, atëherë e kuptova se ishte Suedez.

96. U thashë oficerëve të ZPS-së që të merrnin video incizimet e hedhjes së dokumenteve pasi OVL e kishte të incizuar. Po ashtu u thashë edhe oficerëve të ZPS-së që të merrnin incizimin nga kamerat e sigurisë (CCTV). Megjithatë, zyrtarët e ZPS nuk donin të merrnin incizimet nga kamerat e sigurisë. Zyrtarët e ZPS-se nuk treguan as interesim te flasin me Taiben, edhe pse ishte ajo që e kishte parë dorëzuesin e dokumenteve. Ajo ishte në zyrë në atë kohë, por nuk folën kurrë me të. Në fakt ata nuk e morën askënd në pyetje.
97. Besoj se ZPS ka qëndruar në OVL gjithsej rreth dy orë. Gjatë kësaj kohe ata nuk kryen asnjë kontroll të objektit. Ata as nuk thanë se do të ktheheshin në një fazë të mëvonshme për ta kontrolluar objektin. Nuk u ndërmor asnjë masë sigurie.
98. [REDAKTUAR] ka bërë disa telefonata derisa ishte në OVL, atëherë kur i propozuam ti merrte pamjet nga CCTV, pasi e ndali ai nuk ndryshoj mendje ti merrte.. Më pas ata shkuan dhe nuk kisha më kontakt me ZPS-në deri më 22 shtator 2020.
99. Mendoja se po përcillesha ditën kur po kthehesha nga Shqipëria më 13 shtator 2020. Kur hyra në Kosovë një veturë dukej se po më përcillte. Por mendoja se edhe mund te jete ndonjë i interesuar për të më parë pasi isha edhe person publik tash - dhe nuk e mendova shumë atë punë.
100. Ne kishim bere me herët nje kërkesë në polici për mbrojtje. Çështja ishte se Hysniu mendonte se ai dhe unë po përcilleshim pasi qe ne po udhëtonim shumë shpesh për intervistat në media.
101. Nga data 17 deri më 22 shtator kam qëndruar gjatë gjithë kohës në Kosovë. Gjatë kësaj kohe, nuk kam bërë asgjë tjetër përveç intervistave – ndonjëherë dy ose tri në ditë. Kisha intervista të ndryshme, për shembull, jo vetëm lidhur me këtë çështje, por edhe në lidhje me gjykatat dhe veteranët etj. Gjatë kësaj kohe, isha kritik ndaj DHS. Sugjerimi i DHS se po hetonin ne mënyrë të paanshme nuk qëndronte dhe unë vazhdoja te theksoja se ajo po kryente hetime selektive dhe të njëanshme. Përkundrazi, në vend të kësaj, ata

hetonin vetëm ata qe servoheshin nga Serbia. Dhe se ZPS ishte puro politike. ZPS-ja nuk mbrojti as dëshmitarë të cilëve u premtoi mbrojtje.

Zbulimi i tretë

102. Më 22 shtator 2020, ne ora 11:00 kisha takim me kontigjentin gjerman të KFOR-it te paracaktuar rreth një javë më herët. Këto takime zakonisht i mbaja unë. Sapo fillova takimin ata menjëherë hynë ne temën e ngjarjeve qe kishin ndodh kohëve te fundit e pikërisht për këto dosjet qe kanë ardhur, unë iu thashë se nuk kemi fare ide se nga po vijnë. Vetëm shpreha shqetësimin tim se pavarësisht se po përcilleshim, dokumentet vazhdonin të vinin. Më pyetën nëse isha i sigurt se dikush po më përcillte, dhe unë u përgjigja se isha mjaft i sigurt dhe se ishte e lehtë t'i dalloja. Ata me pyeten a ka mundësi te dalim në ballkon e të shohim nëse mund te e dallosh ndonjërin prej tyre, i ftova të dilnim. Thashë të shohim nëse ata që i kisha vërejtur më herët ishin ende atje. Dolëm ne ballkon unë me tre oficeret qe ishin dhe njëmend aty kishin qene ende ata te cilët mua me kishin ren ne sy dhe ishte lehtë t'i dalloje sepse mbanin çantë shpine, syza dielli dhe kapela bejsbolli, pantallona safari apo xhinse si dhe maska kovidi. Atë dite e vëreja se mu afër derës qëndronte një femër bionde, shtatlartë e veshur ne xhinse; besoj se kjo ishte Zdenka Pumper nga ZPS. Sapo dolëm ne ballkon ata na diktuan filluan te shikojnë me koke larte nga ne dhe unë i piketoja me gisht për oficeret e KFOR-it dhe oficeri i KFOR-it ua drejtoi kamerën dhe ata një nga një filluan te spostohen sa ne filluam të qeshnim nga gjesti i tyre.

103. Sapo u kthjem brenda ne zyre, takimin e bëra ne zyre te Migjen Shales qe ishte ngjit me receptionin, sapo rifilluam bisedën me oficer, vetëm kur kemi dëgjuar zërin e Taibes ku njëkohësisht është hapur dera pa trokitur dhe mu drejtua me fjalët “ O nënkryetar kan ardh prap, i pruni apët”. Zyrtarët e KFOR-it u merakosen se çfarë kishte ndodhur kur e panë Taiben që dukej e shqetësuar dhe përkthyesi i tyre u shpjegoi atyre se çfarë po dëgjonte. Zyrtarët e KFOR-it pastaj u hodhën në këmbë dhe më shoqëruan teksa dola nga dera dhe fola me Taiben, duke u përpjekur ta qetësoja.

104. Kështu që dërgesa mbërriti rreth 20-30 minuta pasi kishim filluar takimin e orës 11. Unë isha duke biseduar me Taiben dhe ajo duke me sqaruar se çfarë kishte pa dhe ne ndërkohë dosjet kishin mbërrir ne zyre te kryetarit, unë

kërkova të shihja se si dukej në kamerën e (CCTV) personi pasi që nuk e kisha par dhe njëkohësisht duke e shikuar oficeret gjerman e shikonin edhe ata dhe e incizonin. U nisa për në zyrën e kryetarit dhe oficeret me pyeten se a mund të vinin edhe ata. Ju thash po dhe ata hyn brenda se bashku me mua të zyra e kryetarit. Filluam t'ua hidhnim nga një sy se çfarë përmbanin dhe se a ishin si material në tersi apo në kopje siç i sillnin zakonisht aty pame se ishin tri kopje me një numër të konsiderueshme faqesh..

105. Megjithatë, e pashë në incizimet e kamerave të sigurisë (CCTV) se këtë herë dërguesi kishte hyrë në korridor dhe nga trupi i nxirrte duke i hedhur në dysHEME tubat e fletëve. Besoj se dërguesi këtë herë ishte person tjetër - bazuar në ato që kisha parë në kamerat e sigurisë (CCTV). Pra, ky person i kishte fshehur dokumentet nën rroba në trup. Në kohën kur kishte mbërritur dërgesa, të pranishëm ishin në recepcion Taibja, një kamerier që po sillte kafe dhe një pale e tretë që kishte ardhur të kryente punë. Kjo mund të shihet në pamjet e video incizimeve. Nuk mund ta shihja dorëzuesin, pasi në atë moment isha në zyrë. E pashë Taiben vetëm kur erdhi në zyrën time. Kur e hapi derën e zyrës, ishte e tronditur dhe tha: "I sollë prapë!". Më vinte keq për të sepse ishte traumatizuar nga këto dërgesa.

106. Në atë kohë ishin edhe zyrtarët e KFOR-it në zyrën e kryetarit kur filluam të shikojmë dokumentet. Këto dokumente ishin vetëm në anglisht.

107. Ishte një lloj pamje tjetër të dokumenteve – që dukej sikur ishte fotokopje. Dukej të kishte një vulë zyrtare në dokumente, por logoja, për shembull, nuk ishte me ngjyrë siç ishte në ato tjerat. Nëse ishin kopje origjinale apo ishin bërë për t'i ngjasuar origjinalit, këtë nuk e di, e as që mund të jem i sigurt se ishin autentike. Ua hodha një sy të shpejtë dokumenteve në gjuhën angleze, por nuk kam mundur t'i lexoj hollësisht pasi që nuk lexoj anglisht, por kam identifikuar se dukej si një draft i aktakuzës kundër ish-presidentit Hashim Thaçi. Ne, kryesia e ngushte e pranishme, në konsultim e sipër mes veti vendosem të thërrasim konferencën për media.

108. Gjatë kohës që ne bisedonim dhe përgatiteshim për konferencë zyrtarët e KFOR-it i shfletonin faqet në mënyrë sistematike. Njëri merrte një faqe, ngrinte faqen lartë dhe një tjetër e fotografonte. Kur vërejtën se po i shikoja ata,

më pyetën nëse u lejohej ta bënin këtë, mua mu duk sikur me provokonin dhe ju thashë me ironi, se nuk ishte problem pasi që ju veç i keni këto. Pyeta nëse veçse mund t'i kishin këto, mu përgjigjen duke reaguar me “jo, jo, jo nuk i kemi”.

109. Zyrtarët e KFOR-it nuk kanë ndërhyrë me asgjë. E vetmja gjë që më kërkuan ishte leja për të bërë fotot. Përveç kësaj, ata nuk luajtën asnjë rol. E vëreja se ishin shumë të shpejtë në fotografimin e të gjitha letrave., dhe më pas duke me thane se po e shohin se jam i zen dhe nuk mund vazhdonte takimi edhe me tutje. U përshëndetem dhe shkuan.
110. OVL ua dërgoi ftesën mediave me email, sikur edhe më herët, dhe më pas pritëm një ose dy orë që të mbërrijnë. Gazetarët mbërritën rreth orës 13:00. U mbajt një konferencë e shkurtër për shtyp. Përsëri salla ishte plot me gazetarë. Pastaj gazetarët mbetën në sallë pasi ishin të zënë me përzgjedhjen e dokumenteve.
111. Besoj se grupi i tretë i dokumenteve përmbante një draft të aktakuzës kundër Hashim Thaçit që ishte afërsisht 100-120 faqe. Në qershor të vitit 2020, Prokurori Special, Jack Smith, kishte njoftuar publikisht se ishte ngritur një aktakuzë kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe të tjerëve, andaj kështu kishim dëgjuar se ekzistonte një aktakuzë para këtij zbulimi, dhe tani e pamë këtë të evidentuar në letër. Këto informata ishin bërë publike në verën e vitit 2020. Personi i kishte dorëzuar 3 kopje. Gazetarët i morën këto kopje. Këto dokumente ishin vetëm në anglisht.
112. [REDAKTUAR] mbërriti në zyrat e OVL-së rreth orës 15:00, afërsisht 5 orë pas dorëzimit të dokumenteve. Kur ai mbërriti, konferenca për shtyp tashmë kishte përfunduar, por në korridor kishte ende disa gazetarë. Por kur erdhën zyrtarët e ZPS-së dhe kur gazetarët i panë zyrtarët e ZPS-së, gazetarët informuan kolegët e tyre dhe shpejt korridori u mbush me gazetarë – disa me kamera. Kështu, unë dhe Hysniu e mbajtëm takimin e mbyllur në zyrën e tij.
113. [REDAKTUAR] mbërriti me disa zyrtarë – disa prej të cilëve ishin të pranishëm në takimin në zyrën e Hysniut. [REDAKTUAR] ishte i vetmi që foli (në shqip) – gjë që ishte e rëndësishme pasi nuk kishte asnjë përkthyes të

pranishëm për të përkthyer. Për më tepër, asgjë nuk u përkthye në anglisht, për oficerët e tjerë të ZPS-së të pranishëm.

114. E pash se [REDAKTUAR] mbante një letër në dorë të cilën ia zgjati Hysniut për ta nënshkruar. Pasi që Hysniu ishte në anën tjetër të tavolinës, i thash nëse mund ta nënshkruaja. E nënshkrova dhe ia ktheva menjëherë. [REDAKTUAR] u ngjit lart, mori dokumentet, i solli dhe i futi në një qese plastike. Nuk ishte qese e mbyllur.

115. E nënshkrova fletëdorëzimin. Nuk dukej të kishte listë të numrit të faqeve të sekuestruara ose që tregonte se çfarë ishin. Fleta e parë e dorëzimit pas dërgesës së parë është nënshkruar nga Fatoni (sepse as Hysniu e as unë nuk ishim të pranishëm). Fletëdorëzimi i dytë është nënshkruar nga Hysniu. Fletëdorëzimi i tretë – është nënshkruar nga unë. Besoj se të tri fletëdorëzimet ishin pak a shumë të njëjta në përmbajtje.

116. [REDAKTUAR] dhe oficerët e ZPS-së më pas u larguan dhe u fotografuan nga gazetarët teksa dilnin nga zyrat e OVL-së. Para largimit, ata nuk kanë bërë kontroll të objektit për dokumentet. Ata as nuk i bënë ndonjë pyetje Taibes rreth asaj që ndodhi kur u dorëzuan dokumentet. As që e morën dikë tjetër të pranishëm në pyetje. [REDAKTUAR] mori vetëm disa inserte filmimi nga kamerat e sigurisë(CCTV) me vete. Besoj se pjesën tjetër kanë mundur ta merrnin kur është arrestuar Hysniu dhe kur kanë bastisur zyrat më 25 shtator 2020.

117. Pas datës 22 shtator 2020, nuk kam pasur asnjë kontakt me ZPS-në. Gjatë kësaj kohe, unë kishte shumë intervista publike – kështu që ata mund të me gjenin kur të donin – por nuk e bënë.

Arrestimi

118. Më 25 shtator 2020 isha në Deçan – që ndodhet rreth 90 km larg Prishtinës. Rreth orës 10:30, e pashë në lajme se zyrtarët e ZPS kishin hyre në zyrat e OVL-së me forca të mëdha dhe të armatosur me armatim të gjatë dhe uniforma kamuflazhi për të kryer kontrollin e objektit. Nuk isha aty dhe u nisa menjëherë për në Prishtinë. Gjate gjithë rrugës kam pasur telefonata nga media

te ndryshme, provova te thërras Hysniun por nuk ma hapi kush telefonin. Provova ta pyesja Fatonin se çfarë po behej aty dhe ai me tha se nuk po merr vesh asgjë dhe se ka mbet i bllokuar nga forcat një kat me poshtë dhe se nuk po e lejojnë me u ngjit lart tek vendi i punës. E pyeta nëse e kishin thirrur avokatin. Më tha se nuk dinte gjë për këtë dhe me tha thirre edhe ti njëherë. E ndërpreva atë telefonatë dhe e thirra z. Tomë Gashi, dhe e pyeta se ku ishte dhe nëse e dinte se çfarë po ndodhte. Më tha se ishte rrugës për duke ardhur në zyrë dhe se do të shihte se çfarë ishte. Ndërkohë, Hysniu më thirri në atë moment. Ai më tha se po e çonin në Hagë dhe se donte që unë të shkoja në zyrat e OVL-së sa më shpejt që të ishte e mundur sepse ZPS donte te jem i pranishëm gjatë kontrollit qe do bënin dhe se nuk po e fillonin pa qene unë i pranishëm dhe se po me prisnin aty deri sa te vij. U përgjigja duke i thënë se veç jam rrugës dhe po përpiqesha qe sa ma shpejt te mbërrri në Prishtinë dhe në zyrat e OVL-së.

119. Derisa mbërrita në zyrat e OVL-së, Hysniu veçse ishte arrestuar rreth një orë e gjysmë më herët. I pashë policët e Kosovës ne rresht para ndërtesës se OVL-se. Mbas tyre pash njerëz me uniforma luftarake, me armë automatike, dy ishin para derës dhe dy pas derës. Policia e Kosovës më kërkuan të bisedoja me njerëzit që kishin mbushur rrugën dhe automjetet nuk mund të lëviznin. Ishin rreth 150 veta dhe kishte edhe shume gazetarë qe kishin vendosur kamerat në mes të rrugës. Dhe policia tha, "ju lutemi u kërkoni që të largohen". Arrita të dal dhe të shpërndaj turmën sipas kërkesës. Personave të grumbulluar u thashë të mos e bllokoni rrugën dhe te qetësoheshin.

120. Gazetarët që ishin të pranishëm në konferencën e mëhershme për shtyp po pyesnin se çfarë po ndodhte me Hysniun. Më pyetën se çfarë do të bëja tani dhe thashë që në orën 17:00 kisha një intervistë me Arsim Lanin në Televizionin T7 dhe këtë intervistë e caktuam ne telefon gjate rrugës qe vija ne Prishtine..

121. Po bisedoja me policët e Kosovës – asnjëri prej tyre nuk ishte zyrtar i ZPS. Brenda zyrave të OVL-së kishte oficerë të ZPS-së, por nuk fola me ta.

122. Pasi pash qe nuk e kishin mbajt premtimin dhe e kishin arrestuar Hysniun, atëherë ju dhashë një interviste gazetarëve qe gjendeshin aty dhe kur pash se koha po me kalonte për ne intervistën e premtuar aty mora një taksi për

të shkuar në intervistën me Arsim Lanin në T7. Rrugës pash një xhip të madh që dukej se po përcillte taksinë. Rrugës për në T7, i telefonova Arsim Lanit dhe e informova se më dukej se po përcillesha dhe i kërkova të vinte poshtë për të më lejuar të futem në ndërtesë ose të ma jepte kodin për hapjen e derës së TV-se. Gazetari Arsim Lani kishte zbritur poshtë duke me prite.

123. Në këtë kohë isha i ulur pranë shoferit në taksì. Kur mbërrita pranë ndërtesës, hapa derën e kerrit dhe u nisa. Në këtë moment ata që më kishin përcjellë dolën me vrap nga ai xhipi që na përcillte dhe më ndaluan. Para se të hyja në rrugën për në TV, më thanë “ndalo se je i arrestuar” dhe filloj të më lexonte diçka në gjuhën angleze duke lexuar nga një portofol që kishte vënë në qafë. E pashë se ata ishin zyrtarë të ZPS-së.

124. U kërkova të mos më preknin nëse nuk kishte policë të Kosovës të pranishëm dhe kërkova që ata të ishin aty dhe ta kryenin arrestimin. Prita pranë veturës së ZPS dhe kur pash se njeri ndër ta ishte po ai suedezi dhe njëkohësisht dëgjova një zë tjetër në suedisht duke me thënë të qëndroja aty e të mos lëvizja. Fillova të komunikoj suedisht me këta zyrtarë të ZPS derisa dëgjuam sirenat dhe mbërritën policia e Kosovës. Policia e Kosovës më kërkuan të bashkëpunoja me ta gjë që e bëra me vullnetin tim. Më pas insistova që të merresha me veturë të policisë së Kosovës. Nuk më kanë prangosur pasi nuk kishte nevojë sepse nuk rezistova.

125. Kurë hymë në lokalet e ZPS-se me thanë se po më dërgonin në Hagë. Pastaj me than se nuk po mund ta organizonin transportin dhe se do flija aty deri të nesërmen, ku edhe më dërguan në aeroportin ushtarak ku më kontrolloi një mjek. Pastaj më kanë futur të vetëm në një aeroplan dhe më sollën në Hagë.

126. Nuk pranoj se ka pasur ndonjë veprim të paligjshëm më 7, 16 apo 22 shtator 2020. Në lidhje me pretendimin për kërcënim të dëshmitarëve, nuk kam kërcënuar askënd. Gjatë debateve në panelet televizive ku përpos njerëzve të shoqërisë civile, gazetarëve kishte edhe jurist të ndryshëm dhe nga ato që i dëgjoja edhe aty ishin këshilla për mua, se po vepra ligjshëm përderisa nuk përmendja dëshmitarë me emër. Ata të gjithë më siguruan se nuk po bëja asgjë gabim pasi nuk kisha përmendur asnjëherë asnjë emër përveç atij të [REDAKTUAR] dhe Vukçeviq – që të dy ishin tashmë në domenin publik.

Andaj, isha shumë i kujdesshëm për ta shmangur këtë. Kurrë nuk jam hakmarrë ndaj askujt për dhënien e dëshmimeve. Asnjëherë nuk kam pasur ndërmend të hakmerrem kundër dëshmitarëve për dhënien e informacioneve ZPS-së. Nuk i kam bërë presion askujt. Nuk kam ndërmarrë kurrfarë veprimesh që do të mund të kenë dëmtuar dëshmitarët. As që kam qenë në dijeni se dikush tjetër e bënte këtë. E vetmja gjë që kam bërë është vetëm lufta për lirinë e vendit tim, pra lufta kundër Serbisë.

127. Nuk kam zbuluar identitetin e dëshmitarëve apo individëve dhe nuk kam folur për provat që këta persona mund t'i kenë dhënë. Vetëm kam përmendur komunikimet ndërmjet ZPS-së dhe institucioneve në Serbi, pasi besoja se kjo deklaratë ishte në interes të publikut. Nuk kam pasur kurrfarë dëshire apo qëllimi për ta nxitur ndonjë dëshmitar që të përmbahet nga dhënia e një deklaratë. Të vetmit njerëz që i kam përmendur me emër ishin zyrtarët serbë që ishin njerëz publikë në poste publike në Serbi, për të cilët dihet se kanë qenë të përfshirë në masakra në Kosovë. Asnjë emër serb nuk është përmendur për sa u përket dëshmitarëve. Kam përmendur vetëm ato që konsideroja se ishte në interes të publikut.

128. Në kohën e thirrjes së konferencave për shtyp, si dhe gjatë gjithë konferencave për shtyp, nuk kam konsideruar se konferencat mund të kenë pasur ndonjë efekt negativ të dëshmitarët. As që e kam menduar se ato mund të bënin që një dëshmitar të mos jepte deklaratë. Këtë as që e kam menduar për arsye se qëllimisht nuk kam përmendur asnjë emër dhe ua kam tërhequr vërejtjen të tjerëve të mos përmendnin emra dëshmitarësh. Kështu, që dëshmitarëve nuk po u bëhej ndonjë dëm. Po ashtu, të vetmit persona të cilëve u dhamë qasje në dokumente ishin gazetarë të përgjegjshëm dhe profesional – Pra jo njerëz që do të keqpërdornin materialin. Ata janë ftuar të konsideronin interesin publik për të bërë publike ekzistencën e rrjedhjeve.

129. Po ashtu nuk kam bërë presion ndaj gazetarëve apo ndonjë mediumi për të zbuluar apo publikuar ndonjë material konfidencial. Vetëm kam këshilluar mediat që të mos bënin asnjë emër publik apo të lexonin deklaratat në publik. Këtë e kam thënë në të tri konferencat për shtyp dhe në debate televizive. Ekzistojnë incizime për këtë. Sigurisht se mediat janë të pavarura.

Sigurisht që nuk e shpërfillin sigurinë e të tjerëve. Për më tepër, ne besojmë se këto dokumente kanë rrjedhë nga ZPS – nëse dikush duhet të mbajë përgjegjësi, duhet të jetë vetë ZPS-ja.

130. Nuk e kisha ndërmend të pengoja rrjedhën e drejtësisë. Nuk e kam përmendur kualifikimin e asnjë personi, qoftë të prokurorëve, hetuesve ose stafit të ZPS-së. Nuk kam kërcënuar dhe as që kam dashur të kërcënoj asnjë pjesëtar të stafit të ZPS-së. Nuk kemi kontaktuar asnjë person zyrtar në përpjekje për të penguar drejtësinë. Nuk është e vërtetë se ne kemi qenë të vetëdijshëm se po pengojmë personat zyrtarë në detyrë. Nuk është e vërtetë se vullneti ynë ishte për ta penguar drejtësinë.

131. Nuk e pranoj që kam kryer veprë penale. Ajo që kam bërë ishte veprim në interes të publikut.

132. Kundërshtoj bashkëpunimin e DHS/ZPS me Serbinë. Ka një histori të gjatë mes shqiptarëve dhe serbëve. Shqiptarët ishin të pushtuar nga Serbia dhe të sunduar nga serbët. Serbët bënë luftë kundër popullatës civile dhe kryen gjenocid në Republikën e Kosovës.

133. Kam menduar se nëse ne nuk reagojmë kundër DHS/ZPS, ne këtë drejtim që kanë marrë, do të ketë vetëm aktakuza të fabrikuara kundër ish-ushtarëve të UÇK-së bazuar në materialet e autoriteteve serbe dhe se kjo mund të kishte efekte shkatërruese për sigurinë dhe stabilitetin e Kosovës. Ne ende nuk e dimë nëse materiali është autentik dhe kemi çdo arsye të besojmë se nuk është. Si rrjedhojë nuk kemi besim në vërtetësinë e përmbajtjes së tij.

134. DHS/ZPS po përpiqen të fshehin bashkëpunimin e tyre me autoritetet serbe, dhe sikletin që kjo u shkakton, duke klasifikuar disa aspekte të hetimeve të tyre si konfidenciale. Ata nuk duhet të lejohen ta bëjnë këtë.

135. Nëse të 'tri rrjedhjet nga (Rrufeja 1, Rrufeja 2 dhe Rrufeja 3) nuk i kishin dorëzuar dokumentet në OVL të UÇK-së duke na inkurajuar ta bëjmë materialin publik, ne nuk do t'i kishim thirrur konferencat për shtyp. Në fund të fundit, nuk do të kishim asnjë material për të diskutuar në konferencat për shtyp. Ngjarjet e shtatorit 2020 ndodhën vetëm pse dikush në DHS/ZPS na

ofroi materialin dhe na inkurajoi që ta prezantojmë atë në media. Ne besojmë se kjo është bërë për t'i heshtur OVL-në e UÇK-së dhe mediat e pavarura në Kosovë që të mos shprehin kritika ndaj DHS/ZPS.

Deklaroj se përmbajtja e kësaj deklarate është e vërtetë për aq sa kam njohuri dhe besim.

Nënshkrimi:

Emri:

Data: